

URDHËR
Nr. 191, datë 29.3.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS MINIMALE TË MBULIMIT ME SIGURIM PËR
NJË NGJARJE TË SIGURUAR DHE SHUMËS MINIMALE TË TËRËSISË SË
DËMSPËRBLIMEVE NGA SIGURIMI, QË JANË TË PAGUESHME GJATË VITIT
TË SIGURIMIT PËR NJË APO MË SHUMË NGJARJE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 65, pika 6, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar dhe suma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje, përcaktohet çdo vit, në bazë të mesatares së vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale për 3 (tri) vitet e fundit, për çdo noter, e përlogaritur nga numrat e koleksionit, si më poshtë:

a) nga 1 deri në 1000 numra koleksioni, suma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe suma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë;

b) nga 1001 deri në 3000 numra koleksioni, suma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë dhe suma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë;

c) nga 3001 deri në 5000 numra koleksioni, suma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 25 000 000 lekë (njëzet e pesë milionë) dhe suma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë;

ç) mbi 5001 numra koleksioni, suma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë dhe suma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë.

2. Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Noterisë vendos që sigurimi kolektiv të jetë i detyrueshëm për të gjithë noterët ose, në rast se Dhoma Kombëtare e Noterisë kontraktton, përzgjedh dhe lidh një kontratë kolektive sigurimi për një grup noterësh, përlogaritja e vlerës përkatëse të primit të sigurimit për çdo noter, kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Çdo noter është i detyruar që jo më pak se 15 ditë përpara lidhjes së kontratës së sigurimit të përlogaritë dhe të njoftojë Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për mesataren e numrave të koleksionit, duke u bazuar në të dhënat që administrohen nga sistemi elektronik dhe nga regjistrat noteriale që mbahen në çdo zyrë noteriale.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)